



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3024/1 Prot.

Rrëshen me, 05 . 10 . 2020

V E N D I M

Nr. 80 datë 30. 09. 2020

PËR
“NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2020”, BASHKIA MIRDITË.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", dhe në Vendimin nr. 60, datë 20.12.2019, të këshillit bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2020", dhe në projekt-vendimin e paraqitur kryetari i bashkisë, këshilli bashkiak pas diskutimeve në seancë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet në buxhetin e vitit 2020, si vijon;
 - a) **Paksim;** Fondi në zërin "Blerje automjeti pëe zjarrfiksen". (Gr.00 Tit.03280 Kap.1 Art.231) për vlerën;.....**152 234** lekë, (tepricë fondi ndërmjet planifikimit të kontartës së lidhur në lekë).
 - b) **Shtohet;** Fondi për shpenzime operative për mirëmbajtjen e automjeteve zjarrfikse për avaritë emergjente, (Gr.00 Tit. 03280 Kap.1 Art. 602), në vlerën.....**152 234** lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë, (drejtoria e menaxhimit financiar dhe buxhetit).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ



KRYETAR

Pjeter PJETRI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al